

P. nr. 206/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- **Departamenti i Krimeve të rënda**, në përbërje nga gjyqtari Sali Berisha-kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarët profesionist Ahmet Rexhaj e Menduh Mulhaxha, antarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mahije Rama, në çështjen penale kundër të akuzuarve M. N. e A. N., që të dy nga P. për vepër penale të lëndimit të rëndë trupor nga neni 154 par. 2 të KPK-së, sipas aktakuzës PP.nr. 1083/2009, të dt. 20.07.2009, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik në praninë e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av. F. Gj. e F. K. nga Peja dhe prokurorit të shtetit Agim Kurmehaj, pas seancës së shqyrtimit gjyqësorë të dt. 17.12.2014, me dt. 19.12.2014, muar dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

1. M. N., i lindur me në fshatin R. e A. K. P, nga babai A. dhe nena Z. e gjinisë S., me vendbanim të përhershëm në P, lagja Kristal rr. "R G" nr..., ka të kryer shkollen e ..., me profesion, i gjendjes së ekonomike, shqiptar dhe shtetas i Republikës së Kosovës.

2. A. N., i lindur me në fsh. R. e A. K. P, nga babai Q. dhe nena D. e gjinisë S. me vendbanim në P, rr. "R G" nr....., ka të kryer shkollën e ..., me profesion ... , i gjendjes së ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLEN FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 12.12.2008 rreth orës 20:25 min. në fshatin Cigë K Pejë, i shkaktojnë lëndime të rënda trupore personit tjetër në atë mënyrën që për ndërsa i dëmtuari A. N. ishte duke u pastruar në banjën e shtëpisë së tij, dy të akuzuarit fillimisht futën në brendi të shtëpisë e me pas në banjo, me ç rast fillojnë ta godasin me shkopinj të dëmtuarin, në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit, ku si pasoj e kësaj të njëjtit i shkakton lëndime të rënda trupore me frakturë;

-me çka si bash kryes kanë kryer vepër penale lëndim i rënd trupor nga neni 154 paragrafi 1 nën paragrafi 5 e lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Ashtu që nga gjykata në bazë të neneve 3, 6, 11 par. 1, 15 par.2, 34, 36 par. 2, 38, 54, 64, nenit 154 par. 1 nën par 5 e lidhur me nenin 23 të KPK-së, si dhe nenit 365. të KPPK-së,

G J Y K O H E N

1. I akuzuari M. N.-me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi .

2. I akuzuari A. N.-me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi .

I dëmtuari A. N., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në procedurën e kontestit të rregullt civil, konform nenit 463 par. 2 të KPPK-së.

Të akuzuarit obligohen në paguar jen e shpenzimeve gjyqësorë në lartësi prej 100 € si dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 50 €, -gjithsejtë 150 €, për secilin veç e veç, të gjitha në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Ish-Prokuroria Publike Komunale tani Prokuroria Themelore në Pejë, ka ngritur aktakuzën PP.nr. 1083/2009, të dt. 20.07.2009, kundër të akuzuarve M.N. e A.N. që të dy nga P, për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor nga neni 154 par. 2 e lidhur me nën par 3 dhe nenin 23 të KPK-së.

Me aktgjykimin e ish-Gjykatës Komunale në Pejë P.nr.833/09 të dt. 20.02.2012, të akuzuarit M.N. dhe A.N., janë shpall fajtor dhe gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 muajve.

Me aktvendimin e ish-Gjykatës së Qarkut në Pejë AP.nr.63/12 të dt.29.11.2012, është anuluar aktgjykimi i Gjykatës Komunale P. nr.833/09 të dt.20.02.2012, për shkak të inkompetencës dhe çështja i dërgohet në kompetencë gjykatës kompetente ish- Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Në seancën e shqyrtimit Gjyqësorë përkatësisht ri-shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare pas disa seancave në vazhdimësi, Prokurori i shtetit në Pejë, mbetet në tërësi pranë aktakuzës së ri kualifikuar nga neni 154 par.2 e lidhur me nën par 3 dhe nenin 23 të KPK-së, në veprën penale të lëndimit të rëndë trupor nga neni 154 par1 nën par. 5 lidhur me nenin 23 të KPK-së, duke kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohet sipas ligjit si dhe të obligohet në shpenzime të procedurës penale.

I akuzuari M. N., seancën e shqyrtimit gjyqësorë deklaroi se nuk kam qenë në vendin e ngjarjes dhe se nuk kam lidhje me këtë punë ngase kam qenë në Rugovë dhe gjatë atyre ditëve pothuaj se kam qenë për çdo ditë në Rugovë për me ngarku landë dhe sa me kujtohet atë ditë jam kthyer rreth orës 6,00 të pas ditës dhe kam qenë se bashku me A. dhe se kemi qenë vetëm unë me A ku me kamion kemi bajtë trupa dhe kemi shku në drejtim të fsh. Zahaq për ti shkarku landet, por në fshatin Qyshk kemi pas prishje në automjetet dhe kemi vonu afër një orë e pastaj jemi shku me i shkarkue në Zahaq. Kemi perfundu shkarkimin diku rreth orës 9,00 dhe kemi ardhë në shtëpi ku secili kemi shkue nepër shtëpinë e vetë, ku i kam ndru teshat jam pastru dhe kam dal në qytet e pastaj kam shkue në Prishtinë ku kam nejtë pak dhe jam kthyer për meqenese nuk kam mund ta takoi personin të cilin kam

planifiku ta takoi. Jam kthy në Pejë rreth orës 12,00 të natës apo edhe me vonë dhe pasiqe jam dal nga shtepia atë natë nuk jam taku ma me A. Unë nuk kam asnjë lidhje me të demtuarin dhe nuk kam fare të bëjë me këtë punë. Ndërsa për vellaun po me ngarkon mu nga se vellai i tij siq e kemi pas rastin e ka gjujtë me e vra vellaun tem.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. N. av. F. Gj. deklaroi se unë konsideroi se nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk ka mund të vërtetohet aktakuza e prokurorit nga se edhe pse i dëmtuari ka deklaruar se i ka vërejtë aty ai ka deklaruar se ka pas perde të padukshme ndërsa deklarata e tij është konfuze dhe kontradiktore për disa detaje sikurse edhe deklarata e bashkëshortes së tij dëshmitares V S, po ashtu e kundërshtoi edhe interpretimin e prokurorit lidhur me procesverbalet e pajtimit nga se në procesverbalin e pajtimit të dt. 30.12.2008 palët janë pajtu për një rrahje paraprake që ishte ba në fsh. Pecaj në Rugovë dhe një fjalosje në Vitomiricë dhe se rasti konkret nuk është përfshirë në këtë pajtim qe dot thotë se i dëmtuari në atë kohë nuk i ka akuzu të akuzuarit me këto pretendime ndërsa procesverbali i pajtimit i dt. 24.tetor 2011 në zyrën e kolegut tim ka pranuar i dëmtuari deklarativisht se të akuzuarit nuk janë personat të cilët e kanë sulmu gjë qe bjenë në kundërshtim me deklaratën e me vonshme të tij e pastaj edhe raporti i oficerit të policisë dt. 12.12.2008 për ngjarjen kritike nga vendi i ngjarjes ku polici ka njoftu se sulmi ka ndodhë nga personat e panjohur nga polici H. O.i njësisë Rosu i cili njëkohësisht është dhëndri i të dëmtuarat i cili në vend të ngjarjes ka arrite para policisë. Andaj të gjitha këto që u thanë konsideroi se nuk ka mund të vërtetohet aktakuza dhe kërkoi që i mbrojturi im të lirohet duke pas parasysh parimin se në rast dyshimi favorizohet i akuzuari, nëse gjykata mendon se janë fajtor atëherë kërkoi nga gjykata që ti merr parasysh rrethanat lehtësuese siç është fakti që nga koha e kryerjes së kësaj veprë kanë kaluar plotë 6 vite dhe se dëmtimi i te dëmtuarit nuk ka pasoja të përhershme ashtu siç ka konstatua edhe ekspertiza. Si dhe fakti se i njëjti ka qenë korrekt gjatë procedurës në gjykatë dhe i propozoi gjykatës që ti shqiptohet një dënim me gjobë apo edhe dënimi i kushtëzuar me të cilin do të arrihej qëllimi i denunshmerisë.

I akuzuari A. N. seancën e shqyrtimit gjyqësorë thekson se nuk kam qenë fare në vendin e ngjarjes dhe se nuk kam lidhje me këtë punë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. N., Av. F. K., deklaroi se parimisht e mbështesë kolegun tim paraprakë dhe mbetem pranë pretendimeve që i kam theksu në fjalën përfundimtare nga shqyrtimi i kaluar i dt. 20.02.2011 si dhe pretendimet e ankesës lidhur me këtë rastë dhe konsideroi se aktakuza nuk është vërtetu për faktin se në procesverbalet e pajtimit të dt. 30.12.2008 të cilën siç deklaroi edhe kolegu paraprak ka të bëjë me një rastë tjetër e jo për rastin në fjalë ndërsa procesverbali mbi pajtimin i dt. 24.10.2011 i cili është lidhë në zyrën time dhe para meje në prezencën e të dëmtuarit dhe të disa dëshmitarëve tjerë të cilët me vullnetin e lirë e kanë nënshkruar dhe aty i dëmtuari deklaroi shprehimisht se të akuzuarit këtu nuk janë personat të cilët e kanë sulmue të dëmtuarin A. e në kontestin e saj duke i vlerësuar edhe deklaratat e të dëmtuarit A. si dhe të dëshmitares V. S. vërejmë se ka shumë[paqartësi dhe kontradikta për faktin se ishte apo s'ishte ndriçimi kishte apo s'kishte perde të dukshme dhe për faktin se dëshmitarja ka deklaruar se janë kthy me automjetin e tyre të cilin e kam vërejtë dhe derisa i dëmtuari ka deklarua se ai ishte automjet i markës Mercedes me ngjyrë te përhimët dëshmitarja nuk ka qenë e sigurte në këtë theksim duke theksu se ai ka qenë Gjip i markës Mercedes dhe ngjyrën nuk e ka përmend, andaj kërkoi nga gjykata kërkoi që këto deklarata mos të pranohen si kredi bile dhe se dëshmitë përkatësisht mbrojtja

e të akuzuarve të merret si e vërtetë dhe të akuzuarit të lirohen nga aktakuza në mungesë të provave duke u mbështetur edhe në parimin “In dubio pro reo”.

I dëmtuari A. N. deklaroi se të akuzuarit i ka kushëriji dhe me të njëjtit përpara i kemi pas raportet e mira ku me ta kemi pas edhe hyrje- dalje ndërsa tani nuk jetojnë në të njëjtin vend derisa këta jetojnë në Pejë e unë jetoj në fshatin Cigë. Para se me ndodhë rasti ka me shumë se një gjysmë viti të akuzuarit nuk me kanë ardhur në shtëpi ndërsa përpara kanë ardhur dhe të njëjtit e kanë ditë mirë se ku unë jetoj. Ndërsa me vonë marrëdhëniet tona nuk kanë qenë të mira sepse kemi pas problem për rrugë në fshatin e lindjes ë Rekë të Allagës konkretisht vëllai im I. N. kishte një problem me vëllain e M. D. e ky ishte një rast e mosmarrëveshjes për shkak të mos lëshimit të rrugës e pastaj ka ardhur deri te tentim-vrasja nga ana e I. dhe ajo ka ndodhë me revole dhe puna e kësaj tentim vrasje është kry ashtu që I e ka kry gjykimin është gjyku dhe e ka mbajte dënimin dhe ma vonë kemi pas një marrëveshje të pajtimit por atë këta e kanë prish nga se kanë dashtë me shku sipas ligjit. Ndërsa për rastin e përparshëm policia më kishte ndaluar dhe se me rastin e ndalimit policia nuk me ka thanë asgjë por me kanë marr deklaratën si dëshmitar dhe me kanë liru. Pasi qe siç theksova me lartë që i kam përcjell në shtëpi të tyre jam kthi në shtëpinë time. Pasi qe jam kthi në shtëpi diku rreth orës 20 në mbrëmje kam shkua në shtëpinë tjetër në afërsi të shtëpisë sime në distancë prej 20 deri në 50 metra e cila gjendet në të njëjtin oborr dhe është në pronësinë e J L i cili ndodhet në A e të cilën shtëpi e kam në mbikëqyrje dhe se aty kam shkue vetun për tu pastruar nga se në shtëpinë time ku banoj nuk ka banjo. Në banjë ka ndriçim dritat nuk kanë qenë të ndezura vetëm në banjo ku ka qenë e ndezur drita e poqit elektrik dhe ku banjo ka hapsinë për afërsisht prej 2 deri 2,30 cm. dhe derisa isha duke u pastru në kaden e banjos ku ka pas të vendosur perde ndërsa dera e banjos ka qenë e mbyllur por pa qels dhe derisa isha duke u pastru kanë hy të akuzuarit M. dhe A. në banjo të cilët unë fillimisht nuk i kam vërejtë për shkak të perdes dhe të cilët me kanë godit me druje me q rast ka ra perdja dhe unë i kam pa që të dytë dhe i kam thirr në emër që të dytë duke u thanë moni dhe qka keni e me pas unë kam rrrshit në kad dhe jam rrexue e ket kanë vazhdu që të më godasin me druje në kry në dorë dhe në kembë duke vazhdu në kohëzgjatje për afërsisht prej 5 minuta derisa gjatë kësaj kohe asnjëri nuk me ka fol dhe nuk ma kanë thanë asnjë fjalë. M. ka pasur të veshur jakne të kuqe dhe farmerka gjinse. M. e kam njoftur në bazë të figurës sepse e njoftë edhe me herët dhe se e kam pa nga se në kry nuk ka pas të vendosur asgjë ndërsa i kam njoftë dytë shumë mirë edhe A. për të cilin nuk me kujtohet se çka ka pas vesh dhe kjo kur është ndërpre ata kanë ikë dhe unë jam qu dhe kam dal deri te dera e jashtme e shtëpisë ku e kam thirr shopen time V. dhe V. kadal dhe me ka pyetë se qka u ba për çka unë i tregova se me kanë ra këta dy duke i thanë për M. dhe A. e pastaj jam kthye prap në banjo për shkak se isha i gjveshur e pastaj V. e ka thirrë H. O. të cilin e kemi dhëndër dhe po ashtu është edhe pjesëtar i policisë për të me qu në spital në Pejë ku kam ndejtë 3-4 ditë nga se kam pas lëndime therrje në dorë e majtë mes brylit dhe shuplakës së dorës kam pas ndrydhje në kokë dhe në kembë ku në kemb kam ende problem. Pas kësaj ka pas përpjekje me u pajtua por nuk ka pas rezultat dhe këto përpjekje janë ba nga kushërinj B.N. i cili me ka ardh dhe me ka thanë nuk mujë me shku ma se me kanë njëkë dhe refuzu dhe se B. këtë iniciativë e kishte ndërmarr vet. Dhe se prej vitit 2008 është shty.

Dëshmitarja V S deklaroi se të akuzuarit i njohë për faktin se janë kushërinj të burrit tim dhe para këtij rasti ata kanë ardhur shpesh në shtëpinë tonë ndërsa natën kritike ka qenë duke rra shi dhe derisa isha duke i mbushur disa shishe me ujë në korridorin e shtëpisë dhe derën e korridorit e kisha të hapur e kam ndijë burrin i cili kishte dal lakuriq duke me thirr hajde se me mbyten, për çka unë u habita duke mëndu se çka e gjet dhe i thash kush more e

ai me tha A. dhe M. kanë hy në banjo dhe me kanë rreh me dru. Nuk ka qenë terr dhe se drita e ballkonit ku kemi qenë na dhe ku ka qenë ai kanë qenë të ndezura dhe jemi pa dhe kur jam shku e kam pa A. të rrexuar dhe me dorën e përgjakur dhe meqenëse ishte dal në ballkon vëreheshin edhe shenjat e gjakut dhe ishte kthyer menjëherë në banjo nga se ka qenë i gj veshur dhe i ka ardh keqe qe ta shofin të afërmit e shtëpisë në atë gjendje e kur kam shkue unë e kam gjete në banjo , banjoja ishte e thyer dhje me ujë në tana onet sikurse edhe me gjaku dhe mbrenda në banjo kishte dritë të ndezur dhe pasi qe mi lypi teshat dhe ja kam pru e pastaj kanë ardhur edhe vllaznia e tij. Unë e kam pa vetëm një kerr në rrugën pas shtëpisë i cili ishte Mercedes me ngjyrën krem dhe me duket se ishte e tipit 190 të cilin automjet e kam përmend edhe ne deklaratën e dhënë në polici. A ka qenë i lënduar në dorë nga se dorën ia kishin thye ka qenë i lënduar në trup dhe në këmbë ku i kishte kope lëkura dhe në krye ka pas lëndime dhe gjak.

Eksperti i mjekësisë-ortopedi dr. I. K., deklaron se sipas urdhrit të gjykatës me dt. 28 prill të këtij viti kam ba një raport të ekspertizës në bazë të dokumentacionit të mangët që kam posedua pa ekzaminimin e të dëmtuarit i cili përpos fletë-lëshimit nga spitali nuk ka raport nga vizitat kontrolluese të me vonshme dhe rëngenografit e domosdoshme për lëndimin e dorës dhe rrjedhjen e lendimit. Natyra e lendimit është vlersuar edhe heren e parë e natyrës së rëndë për shkak të thyerjes së njerës nga kockat e parallërës se majtë(ullës) vlerson për konstatimin e pasojave eventuale kerkohet ajo çka është kerkuar edhe me dt. 28.04.2014 ma konkretisht rengen i parallërës së majtë prezenca e palës me rengen raporti i ortopedit orologut dhe kirurgut. Pastaj eksperti deklaron se i demtuari prapë duhet të shkoi në ekzaminim me kontrollim plotësues dhe pas këtyre mund të deklarohem me saktësisht për pasojat dhe natyrën e lëndimeve me raport për gjykatën.

Gjykata gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të aktakuzës dhe pretendimeve të prokurorit, mbrojtjes së të akuzuarve dhe të mbrojtësve të tyre, dëshmime të dëshmitareve, ekspertizës mjekësore si dhe provat tjera materiale të cilat i vlerësoj veç e veç dhe në ndërlidhje logjike dhe faktike me njëra tjetrën, konform nenit 361. par. 1 e 2. të KPPK-së, përfundoi me vërtetimin e gjendjes faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi ku ekzistojnë të gjitha elementet qenësore të veprës penale për të cilën akuzohen për dy të akuzuarit.

Gjykata gjatë shqyrtimit të provave të administruara e sidomos mbrojtjes së të akuzuarve, vlerësoi se janë jo reale me qëllim të shmangies së përgjegjësisë penale si dhe në kundërshtim me dëshminë e të dëmtuarit dhe të dëshmitares V. S. si dhe të gjitha provat materiale të cilat vërtetojnë faktin se i dëmtuari A. N. natën kritike ishte sulmuar nga të akuzuarit deri sa ishte duke u la në banjën e shtëpisë në shfrytëzim të tij duke u goditur me shkopinj apo mjete të përshtatshme për lëndim, në kokë, trup dhe dorë të cilit i ishin shkaktuar lëndim të rëndë trupor, ashtu siç edhe ishte përshkruar nga aktakuza. Andaj për këtë mbrojtja e të akuzuarve për gjykatën është e pa besueshme dhe si e tillë edhe e pa bazuar.

Gjykata ka provuar që të vërtetoi edhe alibinë e të akuzuarit M. N. nëpërmes të kompanive telefonike vala dhe ipko, por pa sukses për shkak të kohës së kaluar.

Megjithatë duke analizua mbrojtjen e të akuzuarve, sidomos të akuzuarit M. i cili deklaron se ditën kritike ka qenë në Rugovë për bartjen e trupave me kamion, janë kthyer rreth orës 6,00 në fsh. Zahaq për ti shkarku trupat deri rreth orës 9.00 të mbrëmjes dhe pasi që është pastrua ka dalë me automjet në Pejë dhe më vonë edhe në Prishtinë deri rreth orës 12.00, - fakti se rreth kohës së kryerjes së veprës penale 20,25 i akuzuari ka qenë jo me kamion por

me automjetin mercedes në Pejë nga ku edhe vendi i ngjarjes është shumë afër, -është indikativ për mundësinë e të qenurit në vendngjarje -duke krahasuar me dëshminë e V. S., për faktin se dëshmitarja natyrisht në kushte të gjysmë errësirës nuk ka mund të dalloj me saktësi të madhe ngjyrën e automjetit, sikurse edhe për vetë përpjekjet e të akuzuarve për pajtimin sipas marrëveshjes së dt. 24.tetor 2011.

Duke vlerësuar dëshminë e të dëmtuarit A. N., Gjykata konstaton se ajo është reale e saktë dhe në përputhje me dëshminë e dëshmitares V.S. dhe provat tjera materiale, nga se i dëmtuari ka mundur që ti njohë mirë të akuzuarit, të cilët i ka kushërinj dhe i ka njohur edhe më parë, të cilët nuk kanë qenë të maskuar por siç i ka përshkruar me shkopi në dorë nga se banja ka qenë e ndriçuar nga drita elektrike e ndezur deri sa i dëmtuari kishte hy për tu pastruar. Kjo dëshmi është e besueshme për Gjykatën për faktin se dëshmia është e çartë në çdo detal, kurse për të akuzuarin M. ka ekzistua edhe motivi i çartë lidhur me problemet e mëparshme dhe mosmarrëveshjeve në mes tyre.

Po ashtu edhe dëshmia e dëshmitares V. S., për Gjykatën vlerësohet reale dhe e saktë për faktet që i vërteton në kushtet dhe rrethanat që i ka vërejte -se ishte thirr nga bashkëshorti- i dëmtuari A., me fjalët hajde se më mbytën M. dhe A. dhe se ka vërejte të dëmtuarin të rrëzuar të gjakosur dhe të lënduar në kokë, duar dhe në trup dhe ka vërejtur automjetin e markës mercedes duke ikur në rrugën prapa shtëpisë. Kjo dëshmi është në përputhje me atë të dëmtuarit dhe provat materiale, për Gjykatën është e besueshme dhe plotësisht e bazuar për vërtetimin e gjendjes faktike.

Gjykata në shqyrtim gjyqësorë ka administruar edhe provat materiale siç janë: Ekspertiza përkatësisht plotësimi i ekspertizës se ekspertit ortoped Dr. I. K. i dt. 08.10.2014 mbi natyrën dhe pasojat e lëndimeve trupore të të dëmtuarit. Procesverbali mbi pajtimin e palëve me të dëmtuarin të dt. 30.12.2008. Procesverbali i dt. 30.12.08 dhe marrëveshja e dt. 24.tetor 2011, si dhe shkresat tjera të lëndës duke përfshi edhe dokumentacionin mjekësorë, e të cilat vërtetojnë në tërësi lëndimet e shkaktuara të dëmtuarit, të konstatuara edhe në ekspertizë.

Duke vlerësuar ekspertizën e ekspertit ortoped dr. Isa Kaliqani, Gjykata konstaton se ajo vërteton lëndimet e shkaktuara të dëmtuarit si lëndim i natyrës së rëndë- thyerje e parakrahut të majtë dhe plagë prerëse e lëndime tjera të qafës dhe të fytyrës, ashtu siç edhe janë përshkruar në dëshminë e të dëmtuarit dhe të dëshmitares.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarve se nuk ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e aktakuzës, se në banjë ka pas perde të padukshme dhe i dëmtuari nuk ka mund ti shoh dhe identifikoi të akuzuarit, Gjykata konsideron se nuk qëndrojnë ngase janë në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat materiale me qëllim shmangien e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe hudhen si të pabazuara, sepse nëse ka ekzistua perdja e padukshme për të dëmtuarin ajo ka ekzistua edhe për të akuzuarit të cilët me saktësi e vërejtën dhe goditën në pjesët më vitale të trupit të dëmtuarin.

Në Gjykatë gjatë tërë procedurës penale nuk është paraqitur asnjë rrethanë e cila do të përjashtonte apo do të zvogëlonte përgjegjësinë penale të të akuzuarve, për çka nga gjykata konsiderohet se të njëjtit janë personalisht përgjegjës.

Gjatë përcaktimit të masës së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat relevante që ndikuan në llojin dhe lartësinë e saj, si peshën e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të

saj si dhe përgjegjësini penale të të akuzuarve dhe konform nenit 64 të KPK-së, si rrethana rënduese vlerësohet shkalla e lartë e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer, shkalla e përgjegjësive penale të të akuzuarve si kryes të veprës penale si dhe vet motivi, mënyra, natyra, vendi dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale si dhe natyra e lëndimit të shkaktuar. Ndërsa si rrethana lehtësuese vlerësohet fakti se të akuzuarit nuk kanë qenë të dënuar më parë për ndonjë vepër penale, se janë mbajtës të familjeve të tyre, përpjekja e tyre për pajtim me të dëmtuarin dhe vet koha e kaluar që nga kryerja e veprës penale. Me gjithat gjatë vlerësimit të këtyre rrethanave me rastin e matjes së masës së dënimeve të shqiptuara, Gjykata vlerësoi në favor të të akuzuarve rrethanat lehtësuese, duke u përcaktuar për dënim të përafërt me minimumin e përcaktuar ligjor, me bindjen se kjo masë e dënimeve të shqiptuara është adekuate me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer dhe në përpjesëtim të drejt me shkallën e përgjegjësive penale të të akuzuarve, e cila do të ndikoi pozitivisht dhe në mënyrë të mjaftueshme në ndërgjegjësimin e tyre në të ardhmen, si në drejtim të preventivës individuale edhe të asaj gjenerale, e që është edhe vet qëllimi i këtij dënimi në kuptim të dispozitës së nenit 34 par. 1 e 2 të KPK-së.

Me rastin e vendosjes mbi dënimin duke vlerësuar në kuptim të parimit “*refarmatio in peius*” nga neni 395 të KPPK-së, Gjykata konkludon se parimi nuk është shkelur nga se në rastin konkret kishte ankesë edhe në dëmin e të akuzuarve nga përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar si dhe për faktin se çështja në fjalë ishte vendosur nga gjykata in kompetente.

Pala e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike, në pamundësi të përcaktimit të vlerës reale të saj në procedurën penale, udhëzohet në kontestin e rregullt civil, konform nenit 463 par. 2 të KPPK-së.

Të akuzuarit obligohen në paguarjen e shpenzimeve gjyqësorë në lartësi prej 100 € si dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 50 €, -gjithsejtë 150 €, për secilin veç e veç, të gjitha në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Andaj nga sa u tha më lartë e në bazë të dispozitave të lartëcituara ligjore dhe konform nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

U VENDOS NË GJYKATËN THEMELORE NË PEJË, P. nr.206/13, të dt. 19.12.2014.

Procesmbajtësja,
Mahije Rama,

Kryetari trupit gjykues,
Sali Berisha, d.v.

KESHILLA JURIDIKE:

Pala e pakënaqur ka të drejt ankese Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes të kësaj Gjykate, në afatin prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.